

**RELACION
PËR
PROJEKTVENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
“PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË HOLLËSISHËM PËR
PËRCAKTIMIN E MASAVE PARANDALUESE PËR PËRHAPJEN E
ZJARREVE NË TOKA BUJQËSORE”**

**I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN
TË ARRIHEN**

Projektvendimi ka për qëllim të përcaktojë rregullat e hollësishme për marrjen e masave parandaluese për përhapjen e zjarreve në toka bujqësore.

Në zbatim të nenit 16/1, pika 7, të ligjit nr.9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, ngarkohet Këshilli i Ministrave që të nxjerrë aktin nënligjor në zbatim të nenit 16/1, pika 7. Ky projektvendim ka si qëllim të përcaktojë rastet kur ndalohet apo lejohet ndezja zjarreve në tokat bujqësore, vreshtat, pemëtoret, kullotat, shkurret dhe ferrat etj. Gjithashtu përcakon edhe dokumentacionin dhe veprimet që ndërmarrin njësitë e vetëqeverisjes vendore në këtë proces pas kërkesës së subjektit privat që ka në administrim apo pronësi tokën bujqësore.

**II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN
POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN
ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE**

Projektvendimi është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve të vitit 2024, për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për miratim në 4-mujorin e parë, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 790, datë 28.12.2023 “Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2024”.

**III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË,
PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME**

Nisur nga përvoja dhe praktikat e gabuara të deritanishme, për periudhën më të madhe të vitit, vendi ynë është përballur dhe vazhdon të përballë me zjarre të shumta, të ciat janë mjaft problematike dhe shkaktojnë dëme të jashtëzakonshme në tokat bujqësore, dëme të cilat duan vite të rikuperohen dhe toka bujqësore të kthehet në parametrat e mëparshme të pjellorisë. Përveç shqetësimit kryesor, pra dëmtimit të pjellorisë së tokës bujqësore, zjarret, shpesh herë kanë dalë jashtë kontrollit duke dëmtuar pyje, kullota, objekte banimi, si dhe duke dëmtuar mjedisin në përgjithësi, jetën e njerëzve dhe imazhin turistik. Zjarri krijon një imazh tejet negativ për vendin, duke ndikuar edhe në negativisht tek imazhi që krijohet tek vizitorët e huaj, pasi ky proces

përkonë dhe me periudhën më të rëndësishme të vitit atë të sezonit turistik. Ky projektvendim përcakton rregullat dhe masat parandaluese për përhapjen e zjarreve në tokat bujqësore, si dhe përgjegjësitë për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, (bashkitë/njësitë administrative) të cilat duhet:

- të bëjnë verifikimin në terren të ngastrës në të cilën do të ndizet zjarri;
- paraqesin kërkesën në organet për shërbimet e mbrojtjes civile në të cilën argumentohet nevoja e ndezjes së zjarrit, përcaktohet bimësia që do të digjet dhe garantohet përmbushja e kushteve sipas pikës 5 të nenit 16/1, të ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar,
- lëshojnë lejen e ndezjes së zjarrit, pas marrjes së lejes nga shërbimet e mbrojtjes civile.

Në rastet e ndezjes së zjarreve në tokat bujqësore, vreshtat, pemëtoret, kullotat, shkurret dhe ferrat, ku nuk respektohen rregullat e përcaktuara në këtë projektvendim, parashikon penalitete sipas ligjit.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektvendimi hartohet në përputhje me nenin 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Miratimi i këtij projektvendimi buron nga pika 7, e nenit 16/1 të ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS E BE-së (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektvendimi nuk synon përafrimin me acquis e BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është konceptuar në dhjetë pika, me përmbajtje si më poshtë:

Në **pikën 1**, përcaktohet se ndalohet djegia e masës bimore, pjesëve të tyre apo mbetjeve bimore, në tokat bujqësore, vreshta, pemëtore, kullota, shkurre dhe ferra me përjashtim të rasteve kur bazuar në urdhrin e autoriteteve kompetente për arsye që lidhen me shëndetin e bimëve në përputhje me legjislacionin në fuqi, për mbrojtjen e bimëve, mjedisit dhe mbrojtjes civile.

Në **pikën 2**, përcaktohen se në rastet e lejuara nga legjislacioni, djegia kryhet në një zonë të kufizuar dhe të veçuar dhe jo mbi të gjithë sipërfaqen e cila nuk kalon 5 përqind të sipërfaqes së parcelës.

Në **pikën 3, 4 dhe 5**, jepen rastet kur ndalohet procesi djegies.

Pika 6, përcakton periudhën kur lejohet ndezja e zjarreve në tokat bujqësore, në pronësi private apo shtetërore, si dhe dokumentacionin që paraqet

pronari apo përdoruesi i saj, në njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kryerjen e këtij procesi.

Pika 7, përcakton detyrat dhe dokumentacionin që lëshojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore në këtë proces.

Në pikën 8, përcaktohet që shërbimet e mbrojtjes civile, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve sipas pikës 5 të nenit 16/1 të ligjit nr.9244 datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, të ndryshuar, lëshojnë lejen ku përshkruhen masat parandaluese që zjarri të mos dalë jashtë kontrollit, sipas formatit të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Pika 9, përcakton intervalin kohor kur mund të kryhet djegia e masës bimore mbi sipërfaqen e tokave bujqësore, vreshtave, pemëtoreve, shkurreve e ferrave.

Në **pikën 10**, përcaktohen institucionet e ngarkuara për zbatimin e këtij vendimi.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektvendimi është përgatitur nga grupi i punës ngritur me urdhër të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i këtij projektakti nuk ka efekt financiar shtesë për buxhetin e shtetit.

MINISTRI
ANILA DENAJ

